



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
A U T O R I T E T I I K O N K U R R E N C Ë S
D R E J T O R I A E A N A L I Z Ë S D H E M E T O D O L O G J I S Ë S Ë T R E G J E V E

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Rasti i përfimit të kontrollit, të shoqërisë Alpha Bank Albania SHA nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 6 prot., i AK, datë 05.01.2022, “Njoftim përqendrimi: Blerja e Alpha Bank Albania SHA nga shoqëria OTP Bank Plc”, nëpërmjet të cilës jemi njoftuar lidhur me transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë Alpha Bank Albania SHA nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për shitje dhe blerje të aksioneve, palët në kontratë janë:

Pala blerëse: OTP Bank Nyrt, është një shoqëri aksionere publike, objektivi themelor i shoqërisë është: Operimi si një institucion financiar i regjistruar në Hungari, duke vepruar si një institucion krediti (banke) që është i autorizuar të ofrojë gamën e plotë të shërbimeve bankare dhe investimeve dhe me aktivitet kryesor të shoqërisë: Ndërmjetësime të tjera monetare , etj.

OTP Bank Nyrt, është aktive në tregun shqiptar nëpërmjet filialit të saj Banka OTP Albania SHA, shoqëri aksionare, themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: a) pranimi i depozitave monetare ose i fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimi i tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari te vet, b) dhënie huash të të gjitha llojeve duke përfshirë, inter alia, kredi konsumatorësh dhe kredi hipotekore, c) faktoring dhe financim të transaksioneve tregtare, etj.

Pala shitëse: Alpha International Holdings Single Member S.A, është një shoqëri aksionere, e themeluar sipas legjislacionit të Greqisë, me objekt veprimtarie: krijimin ose pjesëmarrjen në subjekte të sektorit financiar, vendas ose të huaj, në përputhje me dispozitat në fuqi.

Shoqëria Target: Alpha Bank Albania SHA, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: Kryerja e aktiviteteve bankare dhe financiare, në përputhje me ligjin ekzistues për bankat apo sipas ndryshimeve që mund të ketë në të ardhmen, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.